



KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME
(TE SHQIPËRISE VLORE STINE SH.P.A.)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

NOTER IRENA BIMO
ADRESA LAGJIA ISA BOLENTINI,
RR. BULEVARDI ISMAIL QEMALI,
GODINA NR. 371
TEL: 0696249592

DEGA VENDORE VLORE

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 2036

Nr. koleksioni: 1243

Vlore më 18/09/2021

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



A2021063990133182830



A2021063990133182830

KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI

(TË SHOQËRISË "VLORA STONE" SH.P.K.)

Sot në Vlorë dt.19/08/2021, para meje Notere IRENA BIMO, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Vlorë, me zyrë në adresën: Lagjja "Isa Boletini", Bulevardi "Ismail Qemali", Nr.371, u paraqitën personalisht:

SHITËS:

Klodian Gllava, atësia Pilo, amësia Roza, shtetas Shqiptar, lindur në Sarandë dhe banues në Tiranë, me adresë: Rruga "Grigor Heba"; Nd. Nd.15; H. 5; Ap. 23; Njësia Administrative Nr. 5; Njesia Bashkiake Nr. 5; 1019 Tiranë, lindur më 30/11/1977, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036032771 dhe nr. personal H71130018K,

(i cili këtu dhe në vijim në këtë kontratë do të quhet "**Shitësi**".)

BLERËS:

Klajdi DEDA, atësia Eltar, amësia Edlira, shtetas Shqiptar, lindur në Vlorë dhe banues në Tiranë, me adresë: Rruga "Fadil Rada"; Nd.1; H. 1; Ap. 22; Njësia Administrative Nr. 2; Njesia Bashkiake Nr. 2; lindur më 24/01/2002, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID me nr. 033776282 dhe nr. personal K20124074J,

(i cili këtu dhe në vijim në këtë kontratë do të quhet "**Blerësi**".)

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noterja konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noterja redaktimin e Kontratës së Shitjes të kuotave të kapitalit të Shoqërisë "VLORA STONE" Sh.p.k., sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

Neni 1. -Të dhënat e pasurisë objekt shitblerje:

-Nga dokumentacioni i paraqitur, rezulton se prane Autoritetit shqiptar "Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), rezulton e regjistruar Shoqëria e emërtuar "Vlora Stone" Shpk, me seli ligjore në Vlorë, Lagjja "Pavaresia", Rruga "Gjergj Kastrioti", Pallati "Çipi 2", e pajisur me Numër Unik Identifikimi (NUIS) L86825208D, me Administrator dhe Përfaqësues ligjor z.Geri ÇIPI, me pjesëmarrje në kapitalin e shoqërisë të ortakëve, respektivisht:

1-Ortaku Ndriçim BABASI zotëron 45,00% (dyzet e pesëpërqind) pjesëmarrje në përqindje në vlerën e kapitalit të shoqërisë ose kontribut në para=45,000.00 (dyzet e pesëmijë) lek;

2-Ortaku Arnold ÇIPI zotëron 22,50% (njëzet e dy presje pesëdhjetëpërqind) pjesëmarrje në përqindje në vlerën e kapitalit të shoqërisë ose kontribut në para=22,500.00 (njëzet e dymijë e pesëqind) lek;

3-Ortaku Geri ÇIPI zotëron zotëron 22,50% (njëzet e dy presje pesëdhjetëpërqind) pjesëmarrje në përqindje në vlerën e kapitalit të shoqërisë ose kontribut në para=22,500.00 (njëzet e dymijë e pesëqind) lek dhe

4-Ortaku Klodian GLLAVA zotëron 10,00% (dhjetëpërqind) pjesëmarrje në përqindje në vlerën e kapitalit të shoqërisë ose kontribut në para=10,000.00 (dhjetëmijë) lek.



A2021063990133182830

Neni 2. -Objekti i shitblerjes:

2.1-Me vullnetin e tij të lirë, Ortaku Klodian GLLAVA ka vendosur të transferoj nëpërmjet shitblerjes në favor të Blerësit Klajdi DEDA, pjesën e tij zotëruese prej 10 (dhjetëpërqind) të pjesëmarrjes në përqindje në vlerën e kapitalit të Shoqërisë "Vlora Stone" Shpk ose kontribut në para në total=10,000.00 (dhjetëmijë) lek.

2.2-Vullneti i mësipërm i kësaj shitje, rezultoi i shprehur dhe i mbështetur edhe në "Vendimin Nr.1, dt. 18/09/2021" të Asamblesë së ortakëve të Shoqërisë "Vlora Stone" Shpk (i cili do t'i bashkëngjitet kësaj kontrate shitblerje dhe do të jetë pjesë përbërëse e saj), nëpërmjet të cilit rezultoi se ortakët e tjerë të shoqërisë Ndriçim BABASI, Arnold ÇIPI dhe Geri ÇIPI, kanë shprehur vullnetin e tyre për aprovimin e shitjes të pjesës zotëruese të ortakut Klodian GLLAVA prej 10 (dhjetëpërqind) të pjesëmarrjes në përqindje në vlerën e kapitalit të Shoqërisë "Vlora Stone" Shpk ose kontribut në para në total=10,000.00 (dhjetëmijë) lek, në favor të Blerësit Klajdi DEDA.

Neni 3. -Çmimi i shitblerjes dhe mënyra e likuidimit:

Palët në këtë kontratë shitblerje deklarojnë se likuidimi nga Blerësi në favor të Shitësit i vlerës në total=10,000.00 (dhjetëmijë) lek të pjesës prej 10 (dhjetëpërqind) të pjesëmarrjes në përqindje në vlerën e kapitalit të Shoqërisë "Vlora Stone" Shpk, është realizuar tërësisht mes tyre jashtë zyrës sime noteriale.

Neni 4. -Garancitë dhe të drejtat e palëve:

4.1-Shitësi e siguron Blerësin se pjesa në total prej 10 (dhjetëpërqind) të pjesëmarrjes në përqindje të zotëruar nga Shitësi në vlerën e kapitalit të Shoqërisë "Vlora Stone" Shpk ose kontribut në para në total=10,000.00 (dhjetëmijë) lek - objekt kontrate shitblerje, është e lirë nga çdo lloj pengu, hipoteke apo barre tjetër ligjore.

4.2-Shitësi i transferon Blerësit nëpërmjet kësaj kontrate shitblerje, pronësinë e plotë mbi pasurinë objekt kontrate shitblerje, e përbërë prej pjesës në total prej 10 (dhjetëpërqind) të pjesëmarrjes në përqindje në vlerën e kapitalit të Shoqërisë "Vlora Stone" Shpk ose kontribut në para në total=10,000.00 (dhjetëmijë) lek, duke i njohur edhe të drejtën e regjistrimit të kësaj kontrate shitblerje pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), për pasqyrimin e kësaj shitblerje në favorin e tij në kollonat përkatëse të Regjistrimit Tregëtar.

4.3-Nëpërmjet kësaj kontrate shitblerje, Blerësi Klajdi DEDA bëhet zotërues i 10,00% (dhjetëpërqind) të kuotave të pjesëmarrjes në përqindje në vlerën e kapitalit të Shoqërisë "Vlora Stone" Shpk ose kontribut në para=10,000.00 (dhjetëmijë) lek.

Neni 5. -Aneksat e kontratës:

Kësaj kontrate i bashkëlidhen si pjesë përbërëse dhe të pandarë këto dokumente që do të quhen Aneksat të Kontratës:

-Vendimi i Asamblesë së Ortakëve meNr.1, dt.18/09/2021, bashkëlidhur "Vertetim Nenshkrimi me Nr. 2035 Repertori", legalizuar nga Notere Irena Bimo;

-Ekstrakt i Regjistrimit Tregëtar për Shoqërinë "Vlora Stone" Shpk, datë 18/09/2021;

-Dokumentet e identifikimit të palëve kontraktuese.

Neni 6. -Baza ligjore:

-Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 705 dhe vijues të tij;

-Ligji 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare";

-Ligji nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë".

Neni 7. -Dispozitat përfundimtare:

-Kontrata e Shitjes të kuotave të kapitalit u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të Palëve kontraktuese; të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe



A2021063990133182830

meqenëse shprehin vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noteres.

-Unë Noterja, verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.

-Në zbatim të Ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

PALËT KONTRAKTUESE

S H I T Ë S

KLODIAN GLLAVA

Klodian Gllava
[Signature]

B L E R Ë S

KLAJDI DEDA

Klajdi Deda
[Signature]

N O T E R E

IRENA BIMO

[Signature]

